



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:327037  
Datë: 17.12.2024  
Numri i dokumentit: 06613981

C.nr.3971/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin, Skender Shala në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. F. nga Komuna e M., të cilin sipas prokurës më shkrim e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Klinaku & Associates, më seli në Komunën e Mitrovicës, kundër të paditurës SHSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. S.H.” të cilën sipas prokurës më shkrim e përfaqëson Dr. Laura Nushi dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, të cilën sipas prokurës më shkrim e përfaqëson Avokatura Shtetërore, më seli në ish objekti i Rilindjes, Komuna e Prishtinës. Objekt kontesti “*Kompensim e te ardhurave nga marrëdhënia e punës*”, vlera e kontestit 869.44 Euro (më fjalë: *tetëqind e gjashtëdhjetë e nënte Euro e dyzet e katër cent*). Jashtë seancë gjyqësore, më datën 17.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses K. F. nga Komuna e M., ne tërësi e pabazuar, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura SHSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. S. H.” dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, që në emër të kompensimit e shtesës në pagë-shujtës mujore, prej datës ... deri më datë 30.08.2024, për 19 muaj, t’ia kompensoj shumën prej ... Euro (më fjalë: ....), të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 për qind, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.
- II. Secila palë vetë i bartë shpenzimet e procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja K. F. nga Komuna e M., nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë ..., pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës ShSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. S.H.” dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, me objekt kontesti “*kompensimin i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”.

Referuar përshkrimin në padi, paditësja që nga data ... i kur ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-196, për pagat në sektorin publik, i është ndërprerë shtesa në pagë-shujta mujore. Tutje ka deklaruar se, me nxjerrjen e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr.Ref. ..., datë ..., duhet t’i njihet e drejta për shtesë në pagë-shujtës mujore. Tani të paditurat, kanë qenë të obliguara ta zbatojnë Vendimin e GjK, në atë mënyrë që të kompensojnë obligimet/detyrimet e ndalura nga data ....., dhe të njëjtat nuk e kanë zbatuar këtë detyrim, andaj i ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar dhe t’i detyroj të paditurat, që paditësit të ia paguaj shtesës në pagë-shujtës mujore, prej datës ... deri më datë ....., për ... muaj, dhe atë me kamatë ligjore prej 8 për qind, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejti se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr....., datës ....., i detyron të paditurat që në afatin prej 15 ditësh të paraqesin përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje, e paditura e parë, më parashtrësën e datës ..., e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka propozuar Gjykatës që ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa e paditura e dytë më parashtrësën e ... (përgjigjen në padi) e kanë kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për shkak të mungesës se legjitimitetit real pasiv për të qenë palë në këtë procedurë dhe i ka propozuar Gjykatës që ta refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësi është e pabazuar, andaj pacaktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsytet si në vijim:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi e padisë së paditësit dhe përgjigjeve në padi, të tani të paditurave, si çështje për argumentim ligjor paraqitet të jetë nëse paditësi i takon kompensimi në emër të shtesës në pagë-shujtës mujore, prej datës ... deri më datë 30.08.2024, kurse për këtë palët ndërgjyqëse kishin qëndrime diametralisht të ndryshme.

Tutje, nga Kontrata e punës më numër të protokollit ....., datë ....., Gjykata e vërtetoi faktin se paditësja ka themeluar marrëdhënien e punës më tani të paditurën e parë, Spitali i Përgjithshëm “Dr. S.H.”, sipas kësaj Kontrate, tani paditësja, si e punësuar tek tash e paditura, mbanë pozitën e punës “Punëtore në shërbimin e kuzhinës e Spitalit Rajonal në Mitrovicë”.

Nga lista e pagave e bashkëngjitur në shkresat e lëndës gjykata vërtetoi faktin se paditësja realizon pagë bazë të rregullt mujore nga Buxheti i Republikës së Kosovës, në shumë prej ... euro.

Gjykata gjen se me Deklarata e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë se Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, numër ..., datë ... *“Nga 1.10.2008 të ketë kompensim në lartësi prej 44 (dyzet e katër) Euro, për të gjithë punëtorët shëndetësorë (13.247), për vitet në vijim”*. Nga vlerësimi i kësaj deklarate, gjykata konstaton se kjo deklaratë nuk e ka fuqinë e aktit ligjor apo nënligjor dhe nuk paraqet dokument detyrues për të paditurën. Kjo nënkupton se, pavarësisht marrëveshjes mes palëve të përfshira, Deklarata nuk ka kaluar procesin e nevojshëm të miratimit ligjor dhe për këtë arsye nuk mund të përdoret si dokument ligjorisht detyrues. Gjykata, duke vlerësuar bazën juridike të kësaj pjese të kërkesëpadisë, konstaton se çdo pretendim për kompensim duhet të mbështetet në një bazë të vlefshme juridike, dhe së këndejmi e paditura nuk mund të detyrohet të përmbushë një kërkesë mbi bazën e një deklarate që nuk ka peshën e një akti ligjor apo nënligjor të miratuar sipas kërkesës përkatëse.

Ndërsa më Vendimin i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me numër ... datë ..., *“Miratohët rritja e pagave duke filluar nga data 01 Janar 2018 për të gjitha kategoritë e të punësuarve që marrin paga nga buxheti i Republikës së Kosovës prej 4% ... si dhe 44 Euro për punëtorët shëndetësor.”* në rastin konkret këtu kemi pasur ngritje në pagë e jo vendim lidhur me shtesat në pagë-shujta mujore, sikurse është përcaktuar në kërkesëpadinë e paditëses. Andaj, lidhur me këtë vendim mbi të cilin e ka mbështetur kërkesën paditësja gjykata konsideron se nuk mund të kërkohej shujta mujore, nga një vendim i cili është vendosur vetëm sa i përket rritjes së pagës prej 4 për qind, apo në vlerë prej 44 Euro, në emër të shërbyesve shëndetësor.

Tutje, me datë ... ka hyrë në fuqi Ligji 08/L-196 për pagat në sektorin publik. Në nenin 1 [Qëllimi] ky Ligj ka përcaktuar se *“qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë”*.

Tutje, Ligji në nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9, ka përkufizuar pagën bazë si vijon *“paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit*

*të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji;”.*

Mandej, në nenin 30 paragrafi 1 të Ligjit është përcaktuar se (Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor) ka përcaktuar shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor dhe njëkohësisht ka përcaktuar edhe kushtet për përfitimin e këtyre shtesave, e që për pasojë, gjykata ka konstatuar se shtesa e pretenduar për shujta nuk hyn në kategorinë e shtesave.

Gjykata konstaton se, Deklarata e përbashkët e Ministrisë së Shëndetësisë se Kosovës dhe Federatës Sindikale të Shëndetësisë së Kosovës, numër .., datë .. dhe Vendimin i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me numër .., datë .., në kohën e hyrjes së tij në fuqi ka ngritur pagat e nëpunësve të shërbimit shëndetësor. Pra, ngritja e pagave për këtë kategori është bërë me Deklaratën në fjalë dhe Vendim qeveritar, për shkak të mungesës së një ligji për pagat në sektor publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, datë ..., është krijuar një sistem i njëtrajtshëm i pagave në sektorin publik, ku përfshihen edhe nëpunësit e sistemit shëndetësor. Së këndejmi, me këtë ligj është përcaktuar paga bazë edhe për nëpunësit e sistemit shëndetësor, e cila i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë. Në këtë kuptim është zëvendësuar sistemin linear të pagave me rastin e hyrjes së tij në fuqi. Megjithatë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për pagat në sektorin publik, është krijuar sistem i ri i pagave, ku është përcaktuar paga bazë. Andaj, duke qenë se në pagën bazë të nëpunësve të sistemit shëndetësor është përfshirë edhe kualifikimi i kërkuar për ushtrimin e funksionit, gjykata konstaton se nga provat e shqyrtuara nuk rezulton themelësia e kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimin e paditëses se me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese është shpallur i pavlefshëm paragrafi 2, 3 dhe 4 i nenit 41(shtesa tranzitore) dhe paragrafi 2 i nenit 45 (shfuqizimi) i Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe mbi këtë bazë paditëses i takon e drejta në kompensim të shujtës mujore. Megjithatë, duke qenë se kërkesa e paditëses nuk mbështetet në një akt ligjor apo nënligjor, por në një deklaratë e cila, për arsyt që u elaboruan më lartë, u konstatua se nuk prodhon efekt juridik, gjykata një pretendim të tillë e vlerëson si të pa bazuar.

Gjykata e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses në raport me të paditurën e dytë Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike pasi i gjeti të bazuara kundërshtimet e Avokaturës Shtetërore të paraqitura përmes përgjigjes në padi. Nga shkresat e lëndës, vërtetohet në mënyrë të pakontestueshme se paditësja është e punësuar tek e paditura e parë SHSUK-Spitali i Përgjithshëm “Dr. S.H.” në M., që nënkupton se me të paditurën e dytë

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, paditësja nuk ka themeluar marrëdhënie pune. Andaj, në prani të këtyre rrethanave e në mungesë të legjitimitetit real pasiv të së paditurës së parë, Gjykata në raport me të njëjtën për këto arsye, kërkesëpadinë e paditëses e refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Duke marrë parasysh nenin 2 paragrafi 1 i LPK-së, ku përcaktohet se *“në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*. Nga interpretimi i dispozitës së lartcekur gjykata konkludon se gjykata është e lidhur me kërkesën e propozuar nga pala ndërgjyqëse dhe rrjedhimisht gjykata nuk ka të drejtë të vendosë për diçka tjetër, që nuk është kërkuar nga pala.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 399 të LPK, e cila dispozitë në paragrafin 1 përcakton *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”*. Ndërsa, me nenin 4 paragrafi 2 i të njëjtit ligj përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Në lidhje me afatin e për Ankesë prej 7 ditësh, Gjykata vendosi në bazë të nenit 476 dhe 477 të LPK.

Vendimin nga pika II e dispozitivit të Aktgjykimit, që secila palë të bartë shpenzimet e veta procedurale, Gjykata e bazoi në nenin 450 të LPK.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 399 të LPK.

## **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**C.nr.3971/2024, datë 17.12.2024**

**GJYQTARI**

**Skender Shala**

### ***UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:***

*Kundër këtij aktgjykimi, lejohet e drejta ne ankese, ne afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.*